




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 1/120
Datë: 16.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 119 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 2/120

Datë: 16.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Aprovohet Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në nivel vendi.
2. Obligohen të gjitha institucionet, që në bazë të vlerësimit të rreziqeve, të hartojnë planin kombëtar të reagimit, të përcaktojnë implikimet buxhetore për trajnime, ushtrime, si dhe për preventivë, reagim dhe rimëkëmbje.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që një herë në dy vjet t'i ofrojë Qeverisë propozime shtesë me të cilat do të plotësojë ndryshimet e mundshme të vlerësimit të rreziqeve.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 3/120


Datë: 16.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafit 1 të nenit 10 të ligjit nr. 03/L- 139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme si dhe nenit 4 paragrafit (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2010, mori

V E N D I M P R E L E M I N A R

1. Miratohet shpronësimi i pronave të paluajtshme në parcelat kadastrale të paraqitura në tabelat e mëposhtme të cilat janë pjesë e këtij vendimi për fillimin e ndërtimit të projektit të Autostradës Vërmicë Merdare, përkatësisht në pjesën e segmentit të zonave kadastrale; Vërmicë, Zhur, Poslisht, Vlashi, Prizren, Atmagjë, Dushanovë, Trepeticë, Petrova Sellë, Caprac, Shpenadi, Velezhë, Novakë të komunës së Prizrenit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit, ndërsa Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit do të jetë në mbështetje teknike të këtij procesi.
3. Obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa që në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Prizrenit, brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen, dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazhin më të madh në Kosovë.
4. Qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera përgjegjëse për kompensimin e pronave, të cilat do shpronësohen, veprojnë në pajtim me ligjin.
5. Kundër këtij vendimi mund të paraqesin ankesë për pjesën e parcelës së vet të pronës pronari apo pretenduesi i pronës e cila do të shpronësohet, subjekti kërkues, dhe zotëruesi i interesit në pronën e prekur në bazë të legjislacionit në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Komunës së Prizrenit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 4/120

Datë: 16.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nënparagrafit 3.1 të nenit 4, dhe paragrafit 5 të nenit 8, të Ligjit nr. 03/L- 139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme si dhe nenit 4 paragrafit (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Shpronësohen pjesët e ngastrave kadastrale të pronave të paluajtshme nga Prizreni deri në Qafë të Duhlës dhe nga Aeroporti i Prishtinës deri në Besi.
2. Vlera e kompensimit të pronave përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, e cila mbështetet nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe kuvendet komunale në territorin e të cilave kalojnë zonat kadastrale që duhet të shpronësohen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe kuvendet komunale, në territorin e të cilave kalon Autostrada.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 5/120
Datë: 16.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Aprovohet buxheti shtesë për Ministrinë e Integrit Evropian në vlerë prej 300.000,00 (treqind mijë) euro për periudhën prill-qershor, sipas këtyre kategorive (deri në rishikimin buxhetor, qershor 2010):
 - 1.1. Paga dhe mëditje 99.000,00 (nëntëdhjetenëntë mijë euro);
 - 1.2. Mallra dhe shërbime 126.000,00 (njëqindnjëzetegjashtë mijë euro);
 - 1.3. Kapitale 75.000,00 (shtatëdhjetepesëmijë euro);
 - 1.4. Numri i të punësuarve në Ministri rritet për 43 nëpunës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë, shpenzime të paparashikuara, dhe barten në kodin e Ministrisë për Integrit Evropian.
3. Obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria për Integrit Evropian për zbatimin e këtij vendimi.
4. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që për pikën 1.4. vendimin t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 6/120
Datë: 16.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2010, mori

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Strategjisë Legjislative për vitin 2010

1. Në Strategjinë Legjislative për vitin 2010 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihen:
 - 1.1. Projektligji për Zgjedhjet Qendrore;
 - 1.2. Projektligji për Kontrollimin e Eksportit;
 - 1.3. Projektligji për themelimin e Agjencisë për Shërbimin e Navigimit Ajror;
 - 1.4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/16 për Regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë;
 - 1.5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë.
2. Bartës i hartimit të Projektligjit për Zgjedhjet Qendrore është Zyra e Kryeministrit.
3. Bartës i hartimit të Projektligjit për kontrollimin e eksportit është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
4. Bartës i hartimit të Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimin e Navigimit Ajror është Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit.
5. Bartës i hartimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/16 për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë është Ministria e Administratës Publike.

6. Bartës i hartimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitim të ish zyrtarëve të lartë është Zyra e Kryeministrit-ZSHNJ.
7. Nga Strategjia Legjislative e vitit 2010 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të hiqet:
 - 7.1. Projektligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të kundërligjshëm të materialeve nukleare dhe materialeve tjera radioaktive;
 - 7.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe
 - 7.3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim.
8. Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile, Projektligji për ekstradim dhe Projektligji për transferimin e personave të dënuar fuzionohen në një projektligj: Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, ekstradim dhe transferim të personave të dënuar.
9. Bartës i hartimit të Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, ekstradim dhe transferim të personave të dënuar është Ministria e Drejtësisë.
10. Afatet e parashtrimit në Qeveri të projektligjeve të kërkuara me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 03-V-261, të datës 25 shkurt 2010, dhe me këtë vendim të parashihen dhe përfshihen në Strategjinë Legjislative për vitin 2010 nga Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit.
11. Obligohet Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAJI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 7/120
Datë: 16.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.
2. Obligohet Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 8/120

Datë: 16.04.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2010, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 100.000,00 (njëqindmijë euro) për të kthyerit në fshatin Zallq të komunës së Istogut.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Ministria për Kthim dhe Komunitete, projekti për komunitete.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Komuna e i Istogut.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Komunës së Istogut
- Arkivit të Qeverisë